

# AKADEMIA E TURIZMIT, MIKPRITJES DHE REKREACIONIT

Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit, funksionon si njësi e specializuar në ofrimin e shërbimeve të trajnimeve dhe kurseve me certifikim në fushën e industrisë së turizmit, mikëpritjes dhe rekreacionit. Këto kurse trajnimi u ofrohen target grupet të industrisë së turizmit dhe ato ndërlidhur me të dhe u përshtatet atyre që kërkojnë të përmirësojnë ose plotësojnë aftësitë e tyre aktuale, në mënyrë që të përshtaten me këtë sektor me zhvillim të shpejtë dhe në zhvillim. Misioni i akademisë është trajnimi dhe certifikimi i profesionistëve, menaxherëve dhe specialistëve për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të industrisë së turizmit dhe sektorëve ndërlidhur me të; ndërmarrja e iniciativave në fushën e turizmit; këshillim për startup-e e bizneseve turistike dhe sektorëve ndërlidhur me të. Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit vjen me dy paketa: Paketa të formimit Profesional Soft Skills dhe Paketa e Trajnimeve Profesionale. Përbajtja e programeve garanton një cilësi dhe përshtatshmëri të lartë me interesin profesional të target grupeve të interesuara.

## NJËSITË

### 1. MENAXHIM TURIZMI

Menaxhimi i Turizmit, si një nga njësitë e Akademisë së Turizmit dhe Rekreacionit, ofron kurse trajnimi dhe aftësimi profesional për atë target grup që punojnë në industrinë e turizmit apo aspirojnë për tu punësuar në sektorin e turizmit. Në këtë njësi përfshihen kurse trajnimi të cilët japin njohuri teorike dhe praktike mbi mënyrën sesi funksionojnë bizneset e turizmit, si sillen turistët dhe çfarë ndikimi ka turizmi në vendet, kulturat dhe mjedisin e tyre. Ndihejmon gjithashtu për të zhvilluar një gamë të gjerë aftësish që mund të zbatohen në një larmi rolesh menaxheriale dhe sipërmarrëse në industrinë e turizmit dhe sektorët ndërlidhës. Programi thekson veçanërisht aspektet kulturore dhe politike të turizmit, modelet e tij të veçanta në shoqëri të ndryshme dhe ndikimin e tij në ekonominë rajonale dhe globale; përgatit target grupet e interesuara për të planifikuar një gamë të gjerë të aktiviteteve turistike dhe për të menaxhuar produktet turistike duke marrë parasysh rrethanat dhe kushtet ekzistuese. Kjo njësi përfshin kurse trajnimi të cilat janë të fokusuar në aspektin menaxherial në fushën e turizmit.

#### *Modul*

- Drejtues teknik në agjensi turistike dhe operator turistik – Kohëzgjatja – 4 muaj – 12 orë/javë
- Sipërmarrja e Agjensisë Turistike - 4 muaj – 12 orë/javë

#### *Kurs*

- Trajnim për Shitjet dhe Marketingun në Hoteleri – Turizëm - Kohëzgjatja – 1 muaj – 12 orë/javë
- Hyrje në Industrinë e Hoteleri- Turizmit - Kohëzgjatja – 1 muaj – 12 orë/javë
- Menaxhimi i Operacioneve në Front Office - Kohëzgjatja – 1 muaj – 12 orë/javë

### 2. SHËRBIME PËR TURISTËT

Turizmi, si produkt, shitet në formën e shërbimeve që u ofrohen turistëve, të cilët shpenzojnë të ardhura për përfitimin e shërbimit. Si e tillë shërbimet e ofruara nga bizneset apo kompanitë turistike, si ato të udhëtimit, shërbimeve në bar-restorante, etj, duhet të justifikojnë koston e turistit. Të punësuar apo ai target grup që aspiron për tu punësuar në kompani apo biznese të shërbimeve turistike duhet të rrisin kapacitetet e tyre profesionale për ofrimin e një shërimi cilësor. Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit, nëpërmjet njësisë: SHËRBIME PËR TURISTËT ofron kurse të shkurtra dhe të gjata të trajnimit dhe perfeksionizimit në sektorin e shërbimeve turistike ku futen: shërbime të udhëtimit, shërbime të akomodimit, shërbime të ushqimit, etj.

## ***Modul***

- Udhërrëfyes Turistik Kombëtar- Kohëzgjatja – 3 muaj – 12 orë/javë
- Udhërrëfyes Turistik Lokal - Kohëzgjatja – 3 muaj – 12 orë/javë
- Udhërrëfyes Turistik – Specialitet i Veçantë (Hiking, Trekking, OffRoad, Scuba Diving, Biking Tours, Stand Up Paddle) 3 muaj – 12 orë/javë
- Rinovim certifikimi(licensimi) për Udhërrëfyes Turistik- Kohëzgjatja – 2 muaj – 12 orë/javë

### **3. DREJTUES (MENAXHUES) NË MIKPRITJE (HOTELE&RESTORANTE)**

Mikpritja në vetvete përfshin të gjithë larmishmërinë e shërbime që u ofrohen turistëve në akomodim apo shërbimet e pijeve dhe ushqimeve. Drejtuesi apo menaxhuesi në sektorin e mikpritjes, si një nga sektorët kycc të industrisë së turizmit, mbikqyr të gjitha detyrat administrative të një hoteli apo vendpushimi. Qëllimi I drejtuesit të një hoteli apo bar restoranti është që ti ofrojë klientit një ambient të ngrohtë, familjar me shërbim cilësor. Industria e turizmit dhe mikpritjes është gjithmonë dhe më shumë në kërkim të rritjes së cilësisë së shërbimit, sidomos kur bëhet fjalë për hotelerinë, restorantet dhe kateringun. Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit, nëpërmjet njësisë: Drejtues (Menaxhues) në Mikpritje (Hotele&Restorante), ofron kurse kualifikimi dhe trajnimi të punonjësve apo atyre të rinjve që aspirojnë për të punuar në fushën e mikpritjes. Disa nga kurset që ofrohen nga kjo njësi janë të listuara në vijim.

#### ***Modul***

- Trajnim për Agjent dhe Menaxherë në Turizëm, Mikpritje, Hoteleri dhe Restorante Kohëzgjatja – 4 muaj – 12 orë/javë

#### ***Kurs***

- Menaxhimi i Operacioneve e Ushqimeve dhe Pijeve- Kohëzgjatja – 1 muaj – 12 orë/javë
- Menaxhimi i Operacioneve të Mirëmbatjes Kohëzgjatja – 1 muaj – 12 orë/javë

### **4. KUZHINË DHE SHËRBIME NË BAR DHE RESTORANT**

Njësia Kuzhinë dhe shërbime në bar dhe restorant vjen si nevojë e plotësimit të kërkesave të tregut të bar-restoranteve për trajnimin/kualifikimin e fuqisë punëtore, në një kohë kur industria turistike dhe sektorët e ndërlidhur me të janë në një zhvillim të hovshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Njësia ofron njohuritë bazë mbi sigurinë ushqimore si dhe teknikat e operimit në kuzhinë dhe shërbimet në bar dhe restorant. Nëpërmjet kurseve të trajnimit synohet aftësimi profesional I punonjësve të kuzhinës dhe bar-restoranteve. Hartimi i menisë, cilësia e përgatitjes së ushqimit si dhe mënyra e servirjes tek klienti si dhe siguria ushqimore janë elementët kyç për një shërbim cilësor. Rritja e numrit të turistëve si dhe e cilësisë që kërkohet nga ana e tyre ka rritur dhe nevojën e përgatitjes së profesionistëve në shërbimet e kuzhinës dhe shërbimeve në bar dhe restorante.

#### ***Kurs***

- Siguria ushqimore - Kohëzgjatja: 1 muaj – 4 orë/javë

### **5. SHËRBIME MIKPRITJE DHE HOTELERIE**

Shërbime mikpritje dhe hotelerievjen si nevojë e plotësimit të kërkesave të tregut për trajnimin/kualifikimin e fuqisë punëtore, në një kohë kur industria turistike dhe sektorët e ndërlidhur me të janë në një zhvillim të hovshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Njësia ofron njohuritë bazë mbi teknikat operacionale të shërbimeve në mikpritje dhe hoteleri. Nëpërmjet kurseve të trajnimit që ofrohen synohet aftësimi profesional i punonjësve që shërbejnë apo synojnë të punojnë në strukturat e mikpritjes dhe hotelerisë.

### ***Kurs***

- Teknikat e Shërbimit të Mikpritjes (Horeca) - Kohëzgjatja: 1 muaj – 5 orë në javë

## **6. SMART TURIZËM**

SMART Turizëm, është një koncept relativisht i ri, i cili është future në industrinë e turizmit si avancim i përparimeve teknologjike dhe innovative. Ai i referohet aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për zhvillimin e mjeteve dhe qasjeve inovative për të përmirësuar turizmin. Smart Turizmi mbështetet në teknologjitë thelbësore si TIK, komunikimi celular, informatika, inteligjenca artificiale dhe realiteti virtual. Ai mbështet përpjekjet e integruara në një destinacion për të gjetur mënyra inovative për të mbledhur dhe përdorur të dhëna që rrjedhin nga infrastruktura fizike, lidhja shoqërore dhe burimet organizative dhe përdoruesit në kombinim me teknologjitë e përparuar për të rritur efikasitetin, qëndrueshmërinë, përvojat. Njësia SMART Turizëm ofron kurse trajnimi dhe specializimi për një sërë shërbimesh dixhitale që mund të ofrohen në sektorin e turizmit, të cilat rrisin cilësinë dhe shërbimin në industrinë e turizmit dhe sektorët e lidhur me të.

### ***Kurs***

- Marketimi Digjital në Turizëm-Kohëzgjatja – 1 muaj – 12 orë/javë
- Paketë formimi profesional soft skills në sektorin e Turizmit – (Përdorimi i mediave sociale në promocionin turistik)  
Kohëzgjatja: 1 muaj – 5 orë në javë

## **PUNËSIMI**

Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit është e lidhur ngushtë me tregun e punës dhe bizneset që operojnë në industrinë e turizmit dhe sektorët ndërlidhur. Si e tillë Akademia ofron suport të vazhdueshëm për kërkesat e klientëve që kërkojnë të trajnohen në një nga fushat që akademia ofron.

- **Jeni duke aplikuar për një punë në industrinë e turizmit?** Akademia ofron orientime, modele, materiale dhe këshilla rreth asaj që dëshirojnë punëdhënësit.
- **Jeni në kërkim të një pune?** Akademia ju ofron kontakte, këshilla dhe ndërmjetësime për të fituar një vend pune në një biznes/kompani për të cilin jeni trajnuar dhe kualifikuar.
- **Vullnetarizmi dhe përvoja e punës.** Akademia ofron kontakte dhe mundësi për të realizuar praktikën (përvojën e punës) apo për rritjen e dijeve praktike nëpërmjet punës vullnetare që mund të ofroni në një biznes turistik.
- **Akoma nuk jeni të vendosur mbi karrierën tuaj dhe po e planifikoni atë?** Akademia ju ofron informacionet e nevojshme për të zhvilluar karrierën tuaj, duke ju prezantuar me njësitë e punësimit në sektorin e turizmit dhe industrinë ndërlidhur me to.
- **Është hera e parë që ju po intervistoheni apo intervistat tuaja kanë qenë të pasukseshme?** Ne ofrojmë këshilla dhe tutoriate sesi të përgatiteni për intervista duke u fokusuar në pikat e fortë që ju keni për pozicionin që aplikoni.

- **Po planifikoni nisjen e një biznesi në industrinë e turizmit? Akademia ofron** konsulenca dhe këshillime nga profesionistët për ngritjen e start up-eve dhe bizneseve tuaja
- **Profile karriere:** Akademia ofron shkëmbime të eksperiencave të mira dhe të sukseshmë në rritjen tuaj në karrierë.
- **Fillimi ose mbarimi i një pune:** Ndhimojmë në procesin e negociimit të pagës suaj dhe kushteve të tjera por dhe në shkrimin e një letre të dorëheqjes.
- **Të drejtat tuaja në punë:** Njihni të drejtat dhe detyrimet tuaja themelore si punonjës.

## GRUPI I SYNUAR

Industria e turizmit është fuqizuar fuqishëm dekadat e fundit, duke rezultuar dhe sektori me numrin më të lartë të të punësuarve në nivel ndërkombëtar. Duke marrë shkas nga ky fakt, Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit ofron kurse/trajnime si dhe këshilla profesionale për punonjësit që punojnë apo aspirojnë për tu bërë pjesë e kësaj industrie apo kërkojnë rritjen në karrierë. Target grupi I synuar janë:

- *Bizneset turistike*
- *Agjensitë turistike*
- *Operatorët turistik*
- *Profesionistët e lirë*
- *Guidatorët turistik*
- *Menaxherët e hoteleve*
- *Punonjësit në bar-restorante*

## FINANCIMI

- Pagesa me këste
- Kurse falas nga donator
- Paguaj pasi të punësohesh

## INDUSTRITË

Turizmi është një industri mjaft dinamike në zhvillimin e saj dhe është e lidhur ngushtë me një sërë industrish ndërlidhur me të, të cilat plotësojnë kërkesat e turistëve. Aftësitë e përfituara kanë mundësi zbatimi në një sërë idustrish si:

- Industrinë e ushqimit dhe pijeve
- Industrinë e Udhëtimeve
- Industrinë e mikpritjes dhe hotelerisë
- Agroushqimin
- Artizanat
- Ekonominë Blu
- Dixhitalizimin dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit

## PSE AKADEMINË:

Ngritja e Akademisë së Turizmit dhe Rekreacionit vjen në përputhje me rritjen e kërkesave të tregut për rritjen e kapaciteteve dhe profesionistëve që operojnë dhe punojnë në industrinë e turizmit. Akademia është e strukturuar në mënyrë të tillë që të jetë sa më funksionale dhe praktike në ofrimin e kurseve/trajnimeve/konsulencës/bashkëpunimeve, etj. Avantazhet që ofron academia lidhen me:

- *Kurse dhe trajnime e shkurtra të formimit profesional (Soft Skill)*
- *Kurse dhe trajnime profesionale*
- *Personalizimi (kurse të personalizuar në varësi të kërkesave)*
- *Ekspertë (trajnuar) profesionistë të fushës*
- *Rritje të aftësive profesionale dhe karrierë e sukseshme*
- *Konsulencë dhe këshillim për start up-e në fushën e turizmit;*